

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA GJUHË SHQIPE



**PUNIM DIPLOME**

**TEMA:** Veprimtaria letrare e Naim Frashërit

Mentori:

Prof. asoc. dr. Kamber Kamberi

Kandidati/ja:

Blerta Hulaj

Gjakovë, 2019

## **Përmbajtja**

Përmbajtja.....	2
Deklarata.....	3
Abstrakti.....	4
Hyrje.....	5
Jeta.....	7
Veprimtaria letrare.....	9
Lirika.....	12
Epika.....	17
Rëndësia e shkrimeve të Naimit në gjuhë të huaja.....	21
Autorët që u morën me jetën dhe veprën e Naim Frashërit.....	24
Të gjitha veprat e Naim Frashërit.....	25
Përfundimi.....	26
Literatura.....	28

## **Deklarata**

Unë Blerta Hulaj, deklaroj se ky Punim Diplome dhe puna e trajtuar këtu, ka përmbajtje tërësisht origjinale.

Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve.

## Abstrakti

Mbi çdo shkrimtar të kohës së vet, Naimi u bë përfaqësuesi më i plotë i idealeve të Rilindjes. Sado që letërsia artistike në gjuhën shqipe kishte njohuri edhe vepra të shquara, siç qenë ato të De Radës, askush përpara Naimit nuk pasqyroi me aq gjerësi dhe nuk iu përgjigj aq flakë për flakë e drejtpërdrejt kërkesave të lëvizjes së çlirimit kombëtar. Me veprimtarinë e dendur letrare dhe me punën si një ndër udhëheqësit kryesor të lëvizjes, ai, me të drejtë, është cilësuar frymëzues i gjithë Rilindjes.

Naim Frashëri vuri themelet e letërsisë kombëtare shqiptare. Vepra e tij shënoi lindjen e një letërsie të re me vlera të vërteta artistike. Ajo shprehte aspiratat e shoqërisë shqiptare të kohës dhe ndikoi fuqishëm në luftën e saj për liri e progres. Naimi krijoi traditën e letërsisë patriotike, qytetare, ai solli në letërsi botën shqiptare, aspiratat jetike të popullit. U vështrua si shkrimtar kombëtar, ndërsa e përgjasuar me atë që bëri Skënderbeu me shpatë.

Dashuria për Atdheun, popullin dhe njeriun, krenaria kombëtare dhe besimi në të ardhmen, ideja e madhe e çlirimit, formojnë thelbin romantik të veprës së tij, e cila ka edukuar breza të shumtë me ndjenjat e larta humanitare dhe të atdhedashurisë; ajo mbetet si një nga vlerat më të çmuara në thesarin e kulturës shqiptare. Naimi e afroi letërsinë me popullin, duke trajtuar tema të reja, të ndryshme nga ato të letërsisë së vjetër, temat e problemet e kohës. Në formimin e Naimit si poet ndikuan disa faktorë, por faktori kryesor ishte jeta e popullit të vet dhe lëvizja e tij për çlirim kombëtar. Naimi njohu disa tradita poetike të huaja, prej të cilave mori elemente që u tretën mjaft natyrshëm në veprën e vet. Por krijimtarisë së tij vulën e origjinalitetit ia vuri jeta dhe tradita historike e artistike e populli të vet. Naimi është bilbili i gjuhës shqipe, mjeshër i fjalës. Tradita që krijoi Naimi, është e gjallë dhe frymëzuese edhe në jetën e shoqërisë sonë të sotme.

### **Fjalët kyçe:**

Atdheu, Rilindja, vepra e tij, çlirimi kombëtar.

## Hyrje

Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj teme dhe pikërisht shkrimtarin Naim Frashërin, është sepse ai dha një nga kontributet më të çmuara në kulturën e re shqiptare dhe në lëvizjen e çlirimit kombëtar, duke mbetur si një nga figurat më kryesore të kulturës shqiptare të të gjitha kohërave. Pikërisht në një kohë kur libra shqip kishte pak, kur kushtet për botimin e tyre mungonin, kur për shkrimin në shqipet dhe për nevojën e shkrimit të librave shqip bëhej fjalë gjithnjë e më shpesh në mesin e intelektualëve të paktë shqiptarë. Me veprimtarinë e tij ai, bënte thirrje për miqësi me fqinjët në kushtet e respektit reciprok, shpallte dashurinë në gjithë popujt e racat, ngrihej me forcë kundër të gjithë armiqve që ishin padrejtësisht kundër kulturës dhe popullit shqiptar, duke admiruar vetitë dhe kulturën e popujve të tjerë (poezinë përparimtare lindore, atë greke, latine, rilindjen evropiane, romantizmin evropian, prej të cilave dhe u ndikua). Ai, me veprimtarinë e tij të gjithanshme si intelektual i madh është më tepër edhe se shkrimtar, është poeti më i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, është atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit dhe i kulturës shqiptare. Naim Frashëri në veprën e tij ka krijuar njeriun e ditur, me karakter dhe moral të lartë, njeriun e qytetëruar dhe civilizues, i cili bashkon dijen me natyrën, mendjen me nderin, aftësinë me përgjegjësinë dhe i cili, në saj të këtyre cilësive të larta, i kupton gjërat dhe nevojat e vendit, i jep ngjyra dhe kuptim jetës dhe e fisnikëron shoqërinë.

Në fillim, Naim Frashëri bëri prova të vjershërimit shqip, siç duket nën ndikimin e bejtexhinjve dhe në këtë kohë u vërehet edhe vjershërimi në persisht. Me këtëedhe pati sukses, duke botuar më vonë edhe një përmbledhje lirikash *Tejhyjlat (Ëndërrimet, 1885)*. Në ndikimin e ngjarjeve historike, sidomos të *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, njëri nga udhëheqësit e së cilës ishte Abdyli, vëllai i tij më i madh, dhe të veprimtarisë kulturore patriotike të *Shoqërisë së Stambollit*, në krye të së cilës ishte Samiu, Naim Frashëri braktisi vjershërimin persisht dhe iu kushtua letërsisë shqiptare. Poema e tij e parë e re ishte *Shqipëria (1880, botuar më 1897)*, që entuziazmoi patriotët shqiptarë.

Veprimtaria e tij letrare e patriotike është e shumanshme dhe luajti një rol të madh. Në Stamboll, Naim Frashëri, ka qenë ndër botuesit kryesorë të revistës "*Drita*", më pas "*Dituria*" (1884-85), ku u botuan shumë vjersha të tij, proza e vargje për shkollat e para shqipe që do të përhapeshin, disa shkrimet dhe përshtatjet e tij. Ai, një kohë shërbeu si anëtar i *Komisionit të Botimeve*, e më pas edhe si kryetar. Shkrimet e tij kryesisht romantike, janë të shumta e cilësore, dhe luajtën një rol të jashtëzakonshëm në kohën e Rilindjes.

Më 1886, Naim Frashëri, botoi poemën e tij të famshme "*Bagëti e Bujqësi*", atë greqisht "*Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*" (*O alithis pothos ton Albanon*) dhe katër libra për shkollat: "*Vjersha për mësonjëtorët e para*", "*E këndimit të çunavet këndonjëtoresa*", (në dy vëllime, me poezi, lexime të ndryshme, njohuri të para shkencore humanitare), si dhe një "*Histori të përgjithshme*". Më 1888 vijoi me "*Diturinë*" (ribotuar më 1895 me titullin "*Gjithësia*", -

shkenca të natyrës). Më 1890 doli përmbledhja e lirikave *“Lulet e verës”*, pastaj *“Mësimet”* (proza patriotike dhe të moralit) dhe *“Fjala flutarake”* (vjersha) më 1894, së fundi më 1898, poema e madhe epike *“Historia e Skënderbeut”* dhe poema fetare *“Qerbelaja”* etj.

Naim Frashëri, u shqua për lirikën e tij patriotike me temë aktuale (vjershat *“Gjuha shqipe”*, *“Korçës”* 1887 etj.), u këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut (*“Bagëti e bujqësia”*) dhe bëri thirrje të fuqishme për çlirimin e tij me krijime si, *“Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”*, shkrime me mesazh për begatimin e vendit dhe një të ardhme demokratike të tij. Ai, i këndoi natyrës, dashurisë (poema *“Bukuria”*, një ndër kryesoret e tij, 1890), miqësisë, jetës intime, brengën atdhetare etj.

Poema *“Historia e Skënderbeut”*, një kurorëzim i veprës së tij, *“testamenti i tij politik e poetik”*, me thirrje të hapëta për çlirim nga Turqia, e cila është shkruar sipas traditës së madhe barletiane. Në poemat epike ai u ndikua nga historitë e vjershëruara të Lindjes dhe nga bejtexhinjtë *frashëriotë*, po duke iu kundërvënë këtyre me shqipen e kulluar apo me shkarkimin e dogmës fetare (në *“Qerbelaja”* dhe në veprat e tjera, që i hartoi për afrimin e elementit besimtar në lëvizjen kombëtare).

Prandaj, në këtë punim diplome do të vështrohet e shtjellohet veprimtaria letrare e shkrimtarit rilindas, Naim Frashëri, Mjeshtëria e tij e cila shfaqet në botimet e veprave të tij si ato poetike-lirike, historiko-kulturore, si dhe shkrimet tjera në gjuhë të huaj. Gjithashtu ndër lidhja e shkrimeve të tij me historinë e popullit shqiptar, nga e cila dhe frymëzohet, por edhe e popujve tjerë. Pra, trajtimi i veprës së Naim Frashërit ka rëndësi të veçantë sepse vepra e tij pasqyron vetë gjendjen e lëvizjes kombëtare të kohës, idealet, realizimet, kufizimet, të gjitha këto të përcjellura edhe me vështirësitë dhe dobësitë e saj.

Për hartimin e kësaj teme kam mëtuar të ndjek metodat e hulumtimit, si metodën historike, të induksionit, deduksionit dhe analizës së veprës, bazuar në literaturën përkatëse.

## NAIM FRASHËRI

### Jeta

Naimi lindi më 25 maj 1846 në fshatin Frashër të Përmetit. Naimi, siç del prej atyre pak kujtimeve që kanë arritur për fëmijërinë e tij, ka qenë një natyrë e ndjeshme, e zgjuar dhe e vëmendshme. Përshtypjet e para ai i pati nga jeta e fshatit, nga mësimet arabisht e turqisht që i jepte hoxha i myhipëve bektashinj, sektë së cilës i përkiste edhe fisi i ti.<sup>1</sup>

Më 1865 , pasi i vdiq i ati, familja u shpërngul në Janinë, ku bashkë me Samiun, Naimi ndoqi gjimnazin “Zosimea”,ku mësuan edhe rilindës të tjerë, si Kristoforidhi, Vretoja, Ismail Qemali me shokë. Aty, ai pati mundësi të njihet me letërsinë dhe filozofinë klasike greke e romake, me pikëpamjet e iluminizmit frëng dhe me historinë moderne të Evropës, sidomos të revolucionit borgjez. Kjo kulturë, gjuhët që mësoi në shkollë e jashtë shkollës, frëngjisht, italisht, greqishte e re dhe e vjetër, latinisht, persisht, bënë që i riu të krijonte një horizont të gjerë dhe të përcaktonte themelet e bashkëkuptimit të vet. Më 1870, pasi kishte mbaruar gjimnazin, Naimi shkoi për të punuar në Stamboll. Stambolli, siç kuptohet prej veprës së Naimit, këtij nuk i bëri përshtypje të mira, me mentalitetin anadollak që aty sundonte. Ai qytet i ngjante edhe më i përshtirë për shkak të ndjenjave patriotike që shqiptari ushqente. Atje nuk i priu dhe shëndeti për të mirë. S’kaloi shumë kohë që Naimi, i prekur në mushkëritë, u kthye në atdhe, për të jetuar në klimë malore. Më vonë (1874-77), atë e gjejmë nëpunës të dhjetash në Berat e drejtor dogane në Sarandë. Kthimi në atdhe pati rëndësi të madhe për jetën e krijimtarinë e tij. Përshtypjeve të fëmijërisë iu shtuan përshtypje të reja, që do të shpërthenin më pas në mjaft lirika. Virtytet, zakonet dhe mënyra e jetesës e popullit të vet, gjuha dhe shpirti poetik i bujqve dhe blegtorëve, qenë një shkollë e vërtetë për shkrimtarin e do t’i jepnin veprës së tij një karakter të theksuar kombëtar e popullor. Natyra shqiptare do t’i mbetej përherë në sy.<sup>2</sup>

Naimi në Shqipëri qëndroi gjer në fund të vitit 1881 dhe jetoi hovin e lëvizjes patriotike, nën drejtimin e Lidhjes Shqiptare. Dimë se mori pjesë në mbledhjen e madhe të Frashërit, më 1879. Sidoqoftë, Naimi ka qenë plotësisht solidar me pikësynimet e Lidhjes dhe propagandist i tyre. Për mbrojtjen dhe çlirimin kombëtar, Naimi ka përkrahur kryesisht tezën e luftës së armatosur kundër pushtuesve. Më 1881 Lidhja e Prizrenit, siç pritej, u ndesh me armë me osmanët. Abdyli u arrestua. Shqipërinë e mbuloi vala më e egër e terrorit dhe Naimi, që u ndodh në Janinë, u vu nën vërejtjen e policisë. Ai qe shpejt i detyruar të shpërngulej familjarisht në Stamboll, ku punonte Samiu . Më nuk u kthye poeti në atdheun e tij.

<sup>1</sup>Sabri Hamiti, “Historia e letërsisë shqiptare“, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.175.

<sup>2</sup>Vepra e cituar, fq. 176.

Po mërgimi i gjatë, bashkë me zhuritjen për Shqipërinë, u dha menjëherë hov dhe frymëzimeve në dobi të çështjes kombëtare dhe veprimtarisë së ti patriotike. Ai tanimë i shtonte vetes detyra themelore për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të bashkatdhetarëve, për shkrimin e gjuhës, përhapjen e kulturës dhe forcimin e luftës së çlirimit.<sup>3</sup>Naimi u bë shpirti i Shoqërisë së Stambollit, që kishte në krye Samiun. Bashkë me Samiun, Naimi ka qenë nismëtar dhe nxitës për organizimin e shoqërive kulturore patriotike të Egjiptit, Bukureshtit e Sofjes.<sup>4</sup>

Në jetën e poetit mund të dallojmë dy faza: faza e parë shkon gjër më 1882; e dyta nis këtu e mbaron me vdekjen e tij. Në këtë fazë ai u bë fytyra më e ndritshme e Rilindjes.<sup>5</sup>Gjithë atë veprimtari shkrimtari i madh patriot e kreu jo vetëm brenda një kohe të shkurtër e me ëndrra shumë, por edhe me shëndetin që i mori shpejt për keq e që s'i premtoi të jetonte gjatë. Ai vdiq, më 20 tetor 1900 ende i ri, në moshën 54 vjeç. Vdiq në kohën kur vepra e tij kishte bërë vend mirë në zemrën e popullit, që përgatitej për betejat përfundimtare të çlirimit të atdheut. E për këto beteja me veprimtarinë e tij dha kushtrimin Naim Frashëri.<sup>6</sup>

Vdekja e Naimit qe një zi e vërtetë kombëtare. Shtypi shqiptar i kohës botoi atëherë shumë artikuj e vjersha, që dëshmojnë për dashurinë e madhe që gëzonte poeti në rrethet e patriotëve dhe në popull. Njëri prej atyre që e përcollën në varr thoshte: << *I varfërë vinja te Naim beu, i pasur shkonja; i urët vinja, i ndrinjët shkonja: pa shpresë vinja, kur shkonja ndjenja vetëhenë të gjall' e me shpirt; fjalët që na thoshte na shëronin zemrën* >>. Dhe kështu e ka shprehur Çajupi dhimbjen e tërë kombit për poetin e madh:

*Vdiq Naimi, Vdiq Naimi,  
moj e mjera Shqipëri!  
Mëndjelarti, zëmërtrimi,  
vjershëtori si ai !...*

*Vdiq Naimi po ç'të gjeti,  
o moj Shqipëri e mjerë!  
Vdiq Naimi, po kush mbeti  
Si Naimi s'ka të tjerë,*

Vdekja e poetit la vërtet një zbrazëti të madhe në radhët e patriotëve dhe të letrarëve, po vetë Çajupi qe ndër ata që e morën dhe e mbajtën me nder flamurin e tij.<sup>7</sup>

<sup>3</sup> Vepra e cituar, fq.178.

<sup>4</sup>Vepra e cituar, fq.179.

<sup>5</sup>Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.460.

<sup>6</sup> Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.180.

<sup>7</sup>Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, fq.463.



## Veprimtaria letrare

Naim Frashëri, u shqua edhe për poezinë meditative, nisi në shqip poezinë filozofike (vjersha "*Perëndia*" 1890). Shkroi dhe proza për të vegjlit dhe bëri disa përshtatje mjeshtërore fabulash të *La Fontenit*. Botëkuptimi i Naimit, ishte në thelb panteist (mishërimi i natyrës me Zotin) e idealist. Me admirimin e madh që kishte për racionalizmin e *Dekartit* dhe si pasues i shquar i iluministëve francezë Volter, Ruso etj., me besimin në shkencat dhe në rolin e tyre në shoqëri (pranimi i teorisë Kant-Laplas. Me demokratizmin e tij, besimin në aftësitë e pashtershme të popullit të vet për të qëndruar, për t'u çliruar, për të vajtur përpara me hov, Naim Frashëri u bë një veprimtar i pashoq në tërë fushat, si shkrimtar, njeri i mendimit, njeri politik etj. E gjithë veprimtaria e tij letrare dhe kulturore ishte e lidhur ngushtë me çlirimin dhe përparimin e vendit. Me çlirimin shpirtëror, arsimimin dhe ndriçimin e masave të popullit. Ai kishte besim të plotë në aftësinë e mendjes për të njohur realitetin e për të vënë në shërbim të njeriut njohjen e ligjeve të botës. Kërkonte arsimim për të gjithë, emancipimin e gruas, qeverisjen demokratike, të vendit (një "*demokraci prej pleqet*", pra të një ngjyre shqiptare), ngrinte lart vetitë e karakterit të shqiptarëve (besën, trimërinë, bujarinë), traditat kombëtare që nga lashtësia pelazgjike. Bënte thirrje për miqësi me fqinjët në kushtet e respektit reciprok, shpallte dashurinë në gjithë popujt e racat, ngrihej me forcë kundër së keqes, pansllavizmit, duke admiruar vetitë dhe kulturën e popujve të tjerë (poezinë përparimtare lindore, atë greke, latine, rilindjen evropiane, romantizmin evropian, prej të cilave dhe u ndikua).<sup>8</sup>

Naim Frashëri, luajti, përkrah Samiut e pas Kristoforidhit, një rol themelor për shqipen e re letrare, të cilën e shkroi me një pasuri të veçantë fjalori e sidomos frazeologjike, duke u mbështetur kryesisht në gjuhën e popullit, e shkroi të pastër dhe bëri një punë të dukshme për pasurimin e saj, duke e ngritur atë në lartësinë e një gjuhe arti të zhvilluar dhe kulture. Ndikimi i Naim Frashëri, me gjallje të shkrimtarit dhe pas vdekjes, jo vetëm të shkrimtarët shqiptarë të kohës, por edhe të periudhës së mëvonshme, ishte i madh. U vunë në pah dhe u çmuan gjerësisht meritat dhe vlerat e punës dhe të krijimtarisë së tij, përmes studimesh të ndryshme. Ribotimet e veprave të tij janë të shumta; përveç tyre janë bërë edhe disa botime kritike shkencore të veprave të Naimit.

*Veprat: "Tejhyjlat" (Ëndërrimet, 1885), "Shqipëria" (1880, botuar më 1897), "Bagëti e Bujqësi", 1886, "Dëshira e vërtetë e shqiptarëve" (O alithis pothos ton Alvanon), "Vjersha për mësonjtoret e para", "E këndimit të çunavet këndonjëtoreja", (në dy vëllime, me poezi, lexime të ndryshme, njohuri të para shkencore e humanitare), "Histori të përgjithshme", "Luleteverës" 1890, "Mësimet, (proza patriotike dhe të moralit), "Fjala flutarake", (vjersha) 1894, "Historia e Skënderbeut", (poemë epike) 1898, "Qerbelaja" (poemë fetare), "Perëndia", 1890, "Fjalët e Qiririt" (publikuar për herë të parë në numrin e parë të revistës "Drita", etj.<sup>9</sup>*

<sup>8</sup>Zija Xholi, "*Mendimtarët e Rilindjes Kombëtare*", 8 Nëntori, Tiranë, 1987, fq.178.

<sup>9</sup>Karl Gurakuqi, "*Shkrimtrët shqiptarë*" (Rilindja 2), Pakti, Tiranë, 2007, fq.111.

Naimi nis të shkruajë shqip që në fëmijëri, nën ndikimin e bejtexhinjve. Nga vargjet e tij të para, na ka arritur vetëm një vjershë e vogël satirike, që dëshmon për shkathhtësinë e autorit. Më vonë, si mbaroi gjimnazin, Naimi u dha kryekëput mbas vjershërisë persishte, të cilën, me sa duket, e braktisi vetëm pas Lidhjes së Prizrenit, kur ai mprehu armët si poet i lëvizjes kombëtare. Në Stamboll poeti vazhdoi të shkruajë dhe të botojë në gjuhë të huaj. Librat e tij të para janë dy broshura turqishte, të dyja të përshtatura nga frëngjishtja, një libër njohurish të thjeshta shkencore dhe një libër këndimi.<sup>10</sup>

Më 1880, kur ziente veprimtaria luftarake e Lidhjes, Naimi shkroi veprën e parë shqip, e cila ndonëse nuk u botua atëherë, i dha emër: “Shqipëria”. Me këtë poemth, sado që në formë të përgjithshme tregimtare, Naimi shpalli disa prej ideve kryesore të Rilindjes dhe të krijimtarisë së tij të mëvonshme: krenarinë për të kaluarën e popullit të vet, dhimbjen për gjendjen e mjeruar të Shqipërisë në robëri, dëshirën për të parë atdheun të lirë e të pavarur.<sup>11</sup>

Brenda viteve 1886-99 u botuan pesëmbëdhjetë vepra të Naimit, të shkruara në një kohë dhe më të shkurtër, sepse, që prej vitit 1895, i sëmure rëndë, ai nuk duket të ketë shkruar më. Ndër to janë : “*Bagëti e bujqesi*”.(1886), “ *Luletë e verësë*“(1890), “*Histori e Skenderbeut*”(1898). Për kohën dhe për shëndetin e Namit, kjo ishte një punë tepër e madhe e kaq e mundimshme, të cilën mund ta kryente vetëm një njeri i sakrificës, me qëllime të larta e vullnet të pathyeshëm.<sup>12</sup>

Duhet pasur parasysh pozicionin e tij, ishte në një post delikat si drejtor i këshillit të cenzurës në Ministrinë e Arsimit të Turqisë, me mundësi në disa raste për t’i bërë bisht ndalimit të librave dhe botimeve në shqipe nga ana e Portës së Lartë, Naimi e pa të arsyeshme të mos përdorte emrin e mbiemrin në shumë nga botimet e veta, por të shënonte vetëm ‘nga N.H.’, ‘nga N.H.F.’, ose ‘ nga N.F.’.<sup>13</sup>

Dhe duke përfutur nga kjo detyrë e censorit të Ministrisë së Arsimit, më 1884 ai mor lejen për botimin e revistës: “*Drita*” (më vonë “*Ditura*”) dhe ishte ndër drejtuesit e bashkëpunëtorët e saj kryesorë. Si patriot e iluminist, ai i jepte rëndësi të dorës së parë pajisjes së popullit me arsim. Për nevojat e shkollave, ai botoi “Vjersha për mësonjëtorët të para”, “Historia e përgjithshme” dhe “E këndimit çunave këndonjëtorëja” (1886), “*Dituritë*”(1888) etj. Këto libra, veç vlerës si tekste të para të shkollës shqiptare, shërbejnë për të rrokur botëkuptimin e autorit, pa harruar vlerat artistike të vjershave e të prozave që gjenden në to.<sup>14</sup>

<sup>10</sup>Grup autorësh “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.468.

<sup>11</sup> Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.178.

<sup>12</sup>Vepra e cituar, fq.179.

<sup>13</sup> Robert Elise, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Botimi i dytë, Dukagjini, Pejë, 2001, fq.175.

<sup>14</sup> Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.179.

Më 1886 doli në Bukuresht poemthi lirik i Naimit, “*Dëshir e vërtetë e shqipëtarëve*”, që ka një rëndësi të veçantë për të njohur idetë e poetit. Kjo vjershë greqishte nuk u bën vetëm shqiptarëve thirrje që të ngrihen kundër Turqisë, po fton edhe fqinjët ballkanas që të rrëmbejnë së bashku me ne armët çlirimtare. Naimi kërkon që populli ynë të rrojë në paqe e dashuri me popujt fqinjë, duke respektuar njëri-tjetrin e duke e ndihmuar.

*Duam me fqinjët gjithënjë të rrojmë, të jetojmë,  
me sllavë, grekë e këdo, me dashuri të shkojmë;  
po me një fjalë, një vështrim thellësidht të kuptohet  
q’ë drekt’ e tjetrit gjithënjë lipset të respektohet.*

Urrejtja e poetit për Turqin buçet e fortë në vargjet e kësaj vjershe. Poemthi u drejtohet bashkatdhetarëve që akoma nuk e përdornin shqipen e që kishin mësuar nëpër shkollat greke. Më 1895 Naimi botoi edhe një tjetër libër të vogël me vjersha greqishte, “*Dashuria*”. Aty poeti u këndon me radhë muzave, duke imituar poezinë klasike të vjetërsisë. Pas Lidhjes së Prizrenit, Naimi e nisi krijimtarinë e tij letrare me disa lirika patriotike dhe me fabula që përshtati nga La Fonteni.<sup>15</sup>

Duhet shënuar se vepra e gjerë poetike e Naimit, që përmbledh afër 30.000 vargje, pa harruar shkrimet e tij në prozë, u krijuan në një kohë tepër të shkurtër, Brenda viteve 1884-1895 ose e tepërmja, 1880-1895, pesëmbëdhjetë vjet. Naimi kishte vetëm kohën që t’i shkruajë veprat e tij, po jo edhe t’i përpunojë në mënyrë të mjaftueshme.<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup>Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.468.

<sup>16</sup>Vepra e cituar, fq.499.

## Lirika

Nga gjithë prodhimi i Naimit, lirika shquhet mbi të tjerat. Vetitë kryesore të lirizmit të tij, janë thjeshtësia e formës dhe ngrohtësia e ndjenjës. Hera-herës, kur poeti frymëzohet nga idetë e ndjenjat e mëdha humanitare, Naimi paraqitet si një poet me gjoks të gjerë, një krijues i madh. Fuqia e fjalës së tij është e madhe, vargu i Naimit ka shumë harmoni.<sup>17</sup>

Lirika zë vendin kryesor në krijimtarinë e Naimit. Mund të themi se ai ishte kryesisht një poet lirik, sado që poema epike “Historia e Skënderbeut” është një nga veprat e tij më me rëndësi, dhe ai shkroi edhe një tjetër poemë të tillë të gjatë, atë me subjekt fetar, “*Qerbelaja*”. Por edhe në këto mund të thuhet, pjesët më të qëlluara janë ato lirike. Veprat kryesore të lirikës së Naimit janë poemat: “*Bagëti e Bujqësia*” dhe “*Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve*” (greqisht), përmbledhjet “*Luletë e verësë*” dhe “*Parajsa dhe fjala fluturake*”, si dhe disa vjersha për shkollat. Në këto krijime, Naimin e gjejmë një poet me ndjeshmëri.<sup>18</sup>

Naimi e shikonte poezinë si mjet për të zgjuar tek shqiptarët ndjenjën e atdhedashurisë, për t’i bërë ata që të hidhen në lëvizjen çlirimtare kundër pushtuesit turk. Ai i kishte vënë vetes për detyrë të bëhet mësues dhe edukator i njerëzve në çdo pikëpamje, duke e pasur të qartë se, për këtë gjë, duhej të sakrifikoje çdo çast të jetës, jetën e vet.<sup>19</sup>

Në lirikën e tij është përfaqësuar njeriu i asaj kohe me një kompleks ndjenjash e mendimesh, me vullte të papërmbajtura patriotike dhe ndonjëherë me rënie shpirtërore për jetën personale, i etur për dituri e përparim dhe i trazuar nga ndjenja e paragjykime mistike, me dashuri të sinqertë e të pastër për njeriun dhe me shpresë se do të arrihet mirëkuptimi dhe harmonia shoqërore, i dhënë në dashuri, por i paçliruar prej patetikës platonike, adhures i natyrës e i fshatit, himnizues i trimërisë e i atdhedashurisë. Të gjitha këto, siç është vënë re, janë përcaktuar prej kushteve historike të periudhës së rëndësishme kur jetoi poeti dhe janë pasojë e ndikimeve të ndryshme, nganjëherë edhe të kundërta filozofike. Si në mbarë krijimtarinë e Naimit, edhe në lirikën e tij vendin kryesor e zë tema patriotike. Janë pikërisht krijimet me këtë temë që e bëjnë shkrimtarin përfaqësuesin më me zë të letërsisë së Rilindjes. Ndër motivet kryesore, të trajtuara në vjersha dhe poema, le të përmendim dashurinë e mallin për atdhe, krenarinë për të kaluarën e atdheut, thirrjet për bashkimin kombëtar e për luftën çlirimtare, urrejtjen për armiqtë e tradhtar. Si gjithë poetët patriot të Rilindjes, Naimi i jep një vend të dukshëm trajtimit të temës së të kaluarës historike, duke u nisur edhe ai nga teza e prejardhjes pelazgjike të shqiptarëve dhe duke u përpjekur, sa herë që i vjen rasti, të përmendë me admirim

<sup>17</sup>Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.499.

<sup>18</sup>Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.193.

<sup>19</sup>Grup autorësh “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.469.

lashtësinë e kombit dhe njerëzit e shquar që Shqipëria ka nxjerrë, gjithnjë me besimin e përsëritjes së lavdisë së dikurshme shqiptare.<sup>20</sup>

Në vjershën e gjatë moralizuese "Parajsa" dhe pastaj në të gjitha krijimet e veta me temë patriotike, Naimi nguli këmbë në domosdonë e bashkimit, i nisur nga mendimi se gjithnjë shqiptarët janë vëllezër të një gjaku dhe të një gjuhe, prandaj edhe mbi interesat e larta kombëtare nuk duhet të vënë asnjë interes tjetër. Një tjetër element, që poeti e përdori për të shkrur atdhedashurinë dhe që vetë, duke u ndodhur në mërgim, e ngriti në lartësinë e idealit të së bukurës, është natyra shqiptare.<sup>21</sup>

Po, siç e kemi vënë re, patriotizmi i Naimit nuk është as sositës, as sentimental. Ai nuk kufizohet me shfaqjen e ndjenjave të përgjithshme të poetit, po lidhet me qëllime e synime të vetëdijshme aktuale dhe për të nesërmen, që i jepin karakter të përcaktuar historik, duke e bërë intensivisht veprues.<sup>22</sup>

Me "*Lulet e verës*" Naimi arriti pjekurinë e plotë si poet lirik. Larmia e motiveve, pasuria dhe thellësia e ndjenjave kanë përcaktuar edhe përdorimin e një gjuhe poetike të larmishme e me shprehësi të lartë. Sa optimist e i ngazëllyer është kur shpreh besimin tek e ardhmja, aq i përmbajtur e meditues është kur flet për probleme të qenies, të filozofisë, sa i trishtuar paraqitet kur kujton djalërinë e perënduar, kohën e ikur, dhe të vdekurit, aq i përndezur është në urrejtjen e tij kur mallkon tradhtarët. Naimi përdori mjete të shumta stilistike. Epitetet e goditura për gjuhën, anaforat tek vjersha "Fyelli", shpërthimet në formë pashirmash "Lum kush të rrojë...", krahasimi i Korçës së Mësonjëtores së parë me trimin që sulet në ballë etj., mbeten të pashlyera në kujtesë. Me shumë efekt poeti përdori edhe antitezat, veçanërisht ndërmjet disa fjalëve të caktuara me kuptim të përgjithshëm, por që ai i shënoi me një përmbajtje të qartë e me ngarkesë emocionale (drita-errësira; fatbardhësia, mbarësia, qytetaria, ndarja, marrëzia), që përfaqësojnë të parat: lirinë, emancipimin, kurse të dytat: zgjedhën, paditurinë, si plagë të pushtimit.

Motivet kryesore që trajtoi Naimi në përmbledhjen "*Lulet e verës*" janë tri: *motivi patriotik, motivet filozofike dhe motivi i dashurisë*. Vjershat e motivit patriotik janë lirika që shprehin ndjenjat qytetare të poetit ndaj atdheut. Një nga përjetimet më të fuqishme të këtij motivi është besimi i palëkundur në të ardhmen e Shqipërisë. Motiv i filozofik zë vend të rëndësishëm të "*Lulet e verës*" dhe mund të themi se Naimi themeloi në letërsinë shqiptare traditën e poezisë së mendimit. Në lirikat filozofike gjejmë përsiatjet e poetit për botën, për jetën dhe vdekjen, për njeriun, përëndinë. Për herë të parë në letërsinë shqiptare trajtohen kaq gjerë koncepte të tilla filozofike, një botë përjetimesh që kanë në qendër njeriun.<sup>23</sup>

*Vjershat e motivit patriotik* ("Shpreh", "Përse", "Gjuha jonë", "Korça", "Tradhëtorët" e ndonjë tjetër) janë lirika që shprehin ndjenjat qytetare të poetit ndaj Atdheut, vlerave të tij dhe fateve të tij. Dy vjersha që lidhen ngushtë nga idetë dhe patosi që i përshkon, janë "Gjuha jonë" dhe "Korça". Në to ai i ka thurur gjuhës shqipe vargjet më të frymëzuara. Është ndër të

<sup>20</sup>Sabri Hamiti, "Historia e letërsisë shqiptare", Rilindja, Prishtinë, 1989, fq. 193.

<sup>21</sup>Vepra e cituar, fq. 194.

<sup>22</sup>Vepra e cituar, fq. 195.

<sup>23</sup>Nonda Bulka, "Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë", Elbasan, 2001, fq. 183.

parët poetë që i këndoi bukurisë dhe ëmbëlsisë së gjuhës sonë, është ndër të parët që kuptoi vlerat dhe mundësitë e saj të shumta për të shprehur mendimet dhe ndjenjat më të thella njerëzore:

*“Gjuha jonë sa e mirë!  
Sa e ëmbël! Sa e gjerë!  
sa e lehtë! Sa e lirë!  
Sa e bukur! Sa e vlerë!” (“Korça”)*

Naimi shkruan plot entuziazëm për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë më 1887 dhe u bën thirrje bashkatdhetarëve të hyjnë me guxim në rrugën e diturisë e të kulturës. Kur ai thotë: "Të marrim diturinë..., tani lipsetë dritë ("Gjuha jonë"), kemi prirjet e tij iluministe dhe përfytyrim se liria nuk shkapet nga përparimi, nga qytetërimi.

**Motivi filozofik** zë vend të gjerë në *"Lulet e verës"* dhe mund të themi se Naimi themeloi në letërsinë shqiptare traditën e *poezisë së mendimit*. Në lirikën *filozofike* gjejmë përsiatjet e poetit për botën, për jetën dhe vdekjen, për njeriun, përëndinë, për kohën që shkon pa kthim. Për herë të parë në letërsinë shqiptare trajtohen kaq gjerë përfytyrime të tilla filozofike, një botë përjetimesh që kanë në qendër njeriun. Me sinjeritet e me gjuhë plot emocione, Naimi shpreh ide humane, dashurinë dhe besimin e tij ndaj njeriut. Në disa nga vjershat filozofike, si: "Jeta", "Zemra" e sidomos "Perëndia", spikat qartë një nga elementet bazë të botëkuptimit të Naimit, panteizmin. Shfaqet aty nga ana mistike e këtij botëkuptimi, por nga ana tjetër, edhe mohimi i riteve të tepruara fetare. Ai pohon se perëndia është kudo, e shkrirë, e trupëzuar te çdo send a gjallesë e botës:

*“Ç’sheh, është zot’ i vërtetë,  
Ç`dëgjon, është zër` i tija,  
Gjithë ç`ka e s`ka në jetë,  
Është vetë perëndia” (“Perëndia”)<sup>24</sup>*

Në panteizmin e Naimit depërton edhe humanizmi, besimi i madh i poetit te njeriu, që është qenia më e lartë e gjithësisë, sepse tek ai, sipas poetit, personifikohet vetë hyjnia.

Motivi erotik është trajtuar në një cikël të tërë vjershash me titullin e përbashkët **"Bukuria"**. Lirikën e dashurisë e kishin lëvruar edhe bejtexhinjtë, por Naimi e ngriti në një nivel artistik të ri. Shpesh përcolli edhe përfytyrime etike e filozofike.

Poeti i këndoi bukurisë së vashës, para së cilës mrekullohet edhe në të zbulon një pjesë të bukurisë universale. Ai e koncepton atë si shfaqje të përsosmërisë njerëzore, të harmonisë dhe bukurisë hyjnore. Ndihet në to edhe ndikim i poezisë orientale. Heroi lirik të kujton bilbilin, kurse vajza e dashur trëndafilin, figura konvencionale të asaj poezie. Ndjenja e poetit është platonike, abstrakte, dhe nuk ka atë shfaqje konkrete si në lirikën popullore ose më vonë si në poezinë e Çajupit. Si romantik, Naimi këndoi më shumë vuajtjet që sjell dashuria, sesa gëzimet e saj. Në këto ndjenja, zbulohet një zemër shumë e ndjeshme dhe mbi të gjitha, shumë njerëzore. Dashuria për poetin është gjithmonë një ndjenjë e lartë, fisnike dhe e pastër.

Në ciklin **"Bukuria"** afrimi me poezinë popullore është mjaft i dukshëm. Poeti mori prej saj mjete artistike e teknika vëzhgimi dhe krijoi vargjet plot natyrshmëri e bukuri të rrallë:

*“Bukuroshe, sy mëshqerrë,  
shikomë njëherë mua,  
trëndafil i kuq me erë  
e di, vallë, se sa të dua?  
E mora vdekjen në sy,  
do të vdes, të vdes për ty”.<sup>25</sup>*

<sup>24</sup>Nonda Bulka, "Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë", Elbasan, 2001, fq. 184.

Vend të veçantë në lirikën patriotike dhe shoqërore të Naimit zë vepra “*Bagëti e Bujqësia*”, e cila vështrohet si kryevepra e tij dhe që, për këtë arsye, vlen të analizohet më vete.<sup>26</sup>

Poema “*Bagëti e Bujqësi*” poeti e mbaroi së shkruari më 5 maj 1886 e ia kushtoi kryetarit të Shoqërisë “Drita” të Bukureshtit, Anastas Lakçes.<sup>27</sup> Kjo poemë është një himn për atdheun, Naimi përherë është i mahnitur para gjithësisë dhe e ka parë natyrën si një mrekulli gëzimsjellëse. Po këtu ai ka më shumë arsye të jetë i mahnitur, pasi nuk flet për natyrën në përgjithësi, ose jo kryesisht për atë, po për vendlindjen, ndaj së cilës, përveç ndjenjës së përgjithshme romantike, e tërheqin sidomos ndjenjat e mendimet e fuqishme patriotike. Kjo lidhje e dyfishtë shpirtërore me fushat e malet, e lumenjtë e pyjet e atdheut, është dhënë në poemë me një fuqi të rrallë ndikuese dhe ka shërbyer e shërben edhe sot për edukimin patriotik të njerëzve.<sup>28</sup>

“*Bagëti e bujqësija*” është njëra prej poemave të para të Naimi Frashërit, e krijuar pas përvojës që kishte fituar duke shkruar vjersha të përmbajtjeve të tjera: të përmbajtjes filozofike, dashurore edhe, sidomos, atdhetare.<sup>29</sup> Në pjesën e parë të kësaj poeme këndohet blegtoria e Shqipërisë. Prej, gjithsejt, 450 vargjeve, sa ka poema, 250 i kushtohen blegtorisë kurse 200 bujqësisë.<sup>30</sup> Vargu i poemës “*Bagëti e bujqësija*” vetëm në shikim të parë është gjashtëmbëdhjetërrrokësh, por në të, vërtetë ai është tetërrrokësh i dyfishuar.<sup>31</sup>

Qëllimi i poemës së Naimit është që të zgjojë e të rritë krenarinë kombëtare, ta bëjë atdheun të dashur e të shtrenjtë për të gjithë. Këtë ai e arrin duke përshkruar me ngjyrat më të bukura natyrën e Shqipërisë dhe duke himnizuar jetën e thjeshtë të blegtorëve e të bujqërve, d.m.th. të masës së popullit tonë. Vjersha nis me vargjet shumë të njohura që na japin menjëherë pamjen e natyrës së atdheut:

*O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë,*

*fushat e gjëra me lule, q’u kam ndër mënd dit’ e natë;  
ju bregore bukuroshe e ju lumënjt e kulluar,*

*çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruara!*

Përshkrimi do të vazhdojë nëpër gjithë vjershën, çdo shqiptar, si dhe poeti, duhet ta ketë për mburrje se mban këtë emër:

---

<sup>25</sup>Nonda Bulka, “*Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë*”, Elbasan, 2001, fq. 186.

<sup>26</sup>Vepra e cituar, fq.197.

<sup>27</sup>Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.470.

<sup>28</sup>Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.198.

<sup>29</sup>Rexhep Qosja, “*Historia e letërsisë shqipe*” (Romantizmi III), Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.187.

<sup>30</sup>Vepra e cituar, fq.188.

<sup>31</sup>Vepra e cituar, fq.200.

*Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emërin shqipëtar;  
zemërnë ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.*

Këto vargje tingëllojnë dhe do të tingëllojnë kurdoherë krenare.<sup>32</sup>

Kjo poemë duket, në vështrim të parë, sikur entuziazmi naimjan buron nga të mrekulluarit përpara natyrës. Në të vërtetë, edhe në përshkrimet e thjeshta, drejtpërdrejt apo në mënyrë të figurshme, me sens të rrallë poetik, autori shkrin zemrën e vet në shpirtin e popullit, siç ndodh në vargje si këto, ku madhështia e natyrës shpreh madhëstini e vetë popullit:

*O malet e Shqipëris, që mbani kryet përpietë,  
tëmerr e frikë përhapni, përpini qiejt e retë!  
Të patundurë për jetë jini, pa, kur oshëtini,  
udhëtaritë në zemrë frikë të madhe i vini.*

Këtë ndjenjë e bënë më të fuqishme, disi edhe krenarisht të dhimbshme, motivi i mallit të poetit, që ëndërron gjithnjë për atdheun e largët dhe këndon:

*Jam larg jush i dëshëruar edhe s'e duroj dot mallë,  
po s'e di si dua unë do t'u shoh një herë vallë?*<sup>33</sup>

Naimi, si rrallëkush tjetër në letërsinë tonë të së kaluarës, i këndoi me frymëzim punës, të cilën, jo vetëm e ka quajtur “*nder për çdo njeri me mend*”, por i ka dhënë, siç thamë, edhe karakterin e një ligji universal për jetën e njeriut, bile edhe për gjithësinë. Te “*Bagëti e bujqësia*”, krahas aspekteve konkrete të punëve të bujkut e blegtorit, autori gjen rastin të kalojë në përgjithësim.

“*Bagëti e bujqësia*” është një ndër krijimet poetike më spontane, ku shpërthen një frymëzim i zjarrtë e i gjerë, që të rrëmben e të hyn thellë në shpirt. Hovet poetike janë të papërmbajtura . Të shpeshta janë vargjet që të ngulen në mendje me kuptimin dhe bukurinë e tyre.<sup>34</sup>

“*Bagëti e Bujqësia*” dallohet si një prej veprave më të bukura poetike të Naim Frashërit. Me qëndrimin aq të rrallë himnizues ndaj natyrës me disponimin posaçërisht të lëvizshëm; me idenë e lartë liridashëse; me ndjenjën aq të ngjyrosur prej një dashurie moralisht aq të çmuar; me filozofinë që e mbartin vargjet e një gjallërie dhe larmie ritmike, figurative, leksikore dhe stilistike të rrallë, me gjuhën aq spikatëse lirike me të cilën ndërtohet ajo pasuri ideoemocionale, poema “*Bagëti e Bujqësia*” e ngre poezinë atdhetare shqipe në një shkallë pjekurie artistike në të

<sup>32</sup>Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.471.

<sup>33</sup>Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.199.

<sup>34</sup>Vepra e cituar, fq.201.



cilën s'kishte qenë kurrë përpara e në të cilën nuk do të jetë edhe një kohë të gjatë pas botimit të saj.<sup>35</sup>

## Epika

Veprat kryesore poetike që botoi Naimi, qenë dy epope, dy poema ose histori të vjershëruara, si: “Qerbelaja” dhe “Historia e Skënderbeut” (1898). E para merret me historinë e shenjtë të islamit, veçanërisht me ngjarjet që interesojnë sektin bektashian. Vepra madhore e Naimit është “Historia e Skënderbeut”, të cilën poeti e shkroi rreth viteve 1890-1895. Me këtë vepër ai përmbushi një nga dëshirat e patriotëve të Rilindjes: të dalë shqip historia e heroit të madh kombëtar. Vepra e Naimit u shkrua dhe u botua në të njëjtat rrethana historike që frymëzuan dhe veprën e Samiut, “*Shqipëria ç’ka qënë ç’është dhe ç’do të bëhet*”, bashkë me të cilën ajo dha vërtet kushtrimin për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Këto dy poema kanë një vlerë të veçantë në veprimtarin letrarë të Naimit dhe që, për këtë arsye, vlen të analizohen më vete.

Poema “*Histori e Skënderbeut*” është e paramenduar si një vepër biografike historike, e shkruar në vargje, domethënë si një vepër që do të ishte, njëkohësisht, edhe histori, edhe poemë epike, me të cilën do të plotësohej zbrastësira e madhe që në atë kohë zotërohej në përvetësimin sa dituror aq edhe emocional të historisë kombëtare të shekullit XV dhe të figurës së saj të madhe, të Skënderbeut.

Këtë poemë Naim Frashëri e shkruan në fund të krijimtarisë dhe, gati, në fund të jetës. Megjithëse e boton vetëm dy vjet përpara vdekjes, më 1898, mendohet se ai këtë vepër do ta ketë shkruar disa vjet përpara se ta botonte dhe, sipas të gjitha gjasave, përpara vitit 1895, kur ende ishte në gjendje të shkruante, dihej se, edhe në këtë kohë, e kishte rënduar një sërë sëmundjesh, duke ia vështirësuar, ashtu, jetën në përgjithësi, dhe duke ia kufizuar mundësitë krijuese, në veçanti.<sup>36</sup>

Për të shkruar historinë e tij të Skënderbeut, Naimi u mbështet në ndonjë nga përshtatjet e shumta që pati vepra e historikut humanist shqiptar, Marin Barletit, në gjuhët që njihte poeti, frëngjisht, italisht ose greqisht. Poeti i ka treguar ngjarjet kronologjikisht; nis nga dërgimi i bijve të Gjon Kastriotit peng te sulltan Murati, dhe e mbaron me vdekjen e Skënderbeut dhe largimin e gruas e të djalit të tij të mitur, Gjonit për në Itali.<sup>37</sup>

Poema është në fakt një histori e vjershëruar, ku pasqyrohen në mënyrën më të plotë ato ndjenja, mendime dhe ideale. Prandaj, në analizën e veprës, është më e udhës të shohim po aq figurën artistike të krijuar nga autori si mishërim të idealeve të veta, si dhe kronikën që ai na ka dhënë, duke u mbështetur në burime të hershme. Skënderbeu, për Naimin, personifikon idealin e

<sup>35</sup> Rexhep Qosja, “*Historia e letërsisë shqipe*”, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.203.

<sup>36</sup> Rexhep Qosja, “*Historia e letërsisë shqipe*” (Romantizmi III), Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.237.

<sup>37</sup> Grup autorësh, “*Historia e letërsisë shqipe I-II*”, Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.487.

bukurisë e të madhështisë njerëzore. Në figurën e tij, poeti ka mishëruar atdashedashurinë, pasurinëshpirtërore dhe fuqinë fizike, urtësinë dhe trimërinë, diturinë dhe mirësinë, demokratizmin dhe karakterin popullor, harmoninë e virtyteve më të larta njerëzore.<sup>38</sup>

Naimi krijoi një Skënderbe ideal, një udhëheqës të tipit legjendar, si e përfytyronte vetë populli, një kreshnik, që “në krahë të djathtë, kur lindi, kish një shenjë si shpatë”, “Mbret i bukurisë”, ai “si dielli epte dritë”; ishte i fuqishëm sa, “njëqind burra ta zinin, ai brengë nuk kishte”. Me pak fjalë:

*kishte të gjitha mirësitë  
dhe të tërë urtësinë,  
njerëzin' e diturinë  
dhe fuqin' e trimërinë  
(Kënga III)<sup>39</sup>*

Në këtë vepër kemi edhe figura të tjera pozitive, përveç Skënderbeut, janë disa prej krerëve shqiptarë të kohës, të cilët e plotësojnë figurën e kryetrimt me vetitë dhe bëmat luftarake të tyre. Njihemi që në fillim të poemës me Gjon Kastriotin dhe me personazhin e krijuar të Kamanit, të karakterizuar prej qëndrimit që ata mbajnë në këshillin e luftës. Fjalët e Kamanit trim e të hakërryer tingëllojnë si kushtrim për bashkëkohësit e poetit:

*Mori kordhënë ndër duar  
e qëndroi në mest si burrë,  
me fytyrë t'ashpëruar,  
ngriti gishtin dhe tha; << Kurrë >>!  
(kënga I)*

Tek fjalimi i gjatë e i zjarrtë i Kamanit, poeti ka dhënë programin e qëndresës luftarake kundër pushtuesve dhe ka shprehur bindjen se :

*Po ta bëjmë besa-besë  
e të mbledhet Shqipëria,  
ahere le të na presë,  
ta shihni ç'është Turqia.*

Në vepër spikatin edhe figurat dramatike të Moisi Golemit e të Hamza Kastriotit.<sup>40</sup>

Ndër personazhet e tjera pozitive që krijoi Naimi te “*Historia e Skënderbeut*”, një farë vendi zënë prindërit dhe e shoqja e heroit. Poeti i ka individualizuar pak. Gjon Kastrioti na

<sup>38</sup> Sabri Hamiti, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Rilindja, Prishtinë 1989, fq. 212.

<sup>39</sup> Vepra e cituar, fq. 216.

<sup>40</sup> Vepra e cituar, fq. 218.

përshkruhet si një princ i urtë, që ka ditur të bëjë të lumtur vendin, fort i dashur e i thjeshtë me popullin.<sup>41</sup>

Nëna e Skënderbeut përshkruhet dhe ajo si grua e thjeshtë, pa madhështinë e radhës së vet, që punon në vegjë dhe qeveris shtëpinë. Dhimbja e saj është e madhe, kur i shoqi i tregon se duhet t'ia dërgojmë djemtë peng sulltanit; po dhe princesha për Shqipërinë e mposht dhëmkën e saj prej nëne. Poeti i ka përshkruar bukur ato çaste. Vdekja e saj, pas vdekjes së të shoqit, me mallin e zhuritur të fëmijëve, është një nga çastet më të realizuara të poemës. E shoqja e Skënderbeut, është paraqitur më pak, veçanërisht nga fundi, pas vdekjes së heroit, kur le Shqipërinë bashkë me të birin e mitur, Gjonin.<sup>42</sup>

Në poemë, përveç anës së thjeshtë historike, Naimi ka gjetur rastin, drejtpërdrejt e përmes figurave pozitive, për të shprehur gjerësisht pikëpamjet e veta shoqërore, politike dhe etike, sidomos në këngën II, me porositë që u jep Gjon Kastrioti të bijve, në këngën XII, me përfytyrimin fantastik të parajsës e të skëterrës, ku renditen gjithë mirësitë e ligësitë, në këngën XX, në të cilën Skënderbeut u lë porositë e fundit bashkëluftëtarëve të vet. Me gjithë karakterin historik, poema, për disa arsye, kryesor pati një tingëllim të fortë aktual në kohën kur u botua: së pari, vetë tema dhe materiali historik i qëndresës heroike të shek.XV u përgjigjeshin rrethanave dhe qëllimeve patriotike të lëvizjes së Rilindjes; së dyti, së, gjatë përshkrimit të kohës së Skënderbeut, janë hedhur gjithë parullat e rilindësve; dhe së treti, se Naimi shpesh e ka theksuar aktualizimin e veprës përmes krahasimeve me kohën e tij dhe përmes ndërhyrjeve direkte poetike.<sup>43</sup>

Poema, në njëzet e dy këngë, është shkruar me vargje tetërokëshe; ndërtimi i saj ndjek rendin kohor të ngjarjeve. Është një vepër prej rreth dhjetëmijë vargjesh, me pjesë këngësh dhe këngë shumë të bukura, siç janë: nisja e djemve peng, vdekja e Vojsavës, takimi i hijës së Gjon Kastriotit me të birin, kthimi i Skënderbeut në Krujë, dhe shumë pjesë të veçanta të këngëve të tjera, në të cilat shkëlqen talenti i Naimit. Po, në tërësi, vepra është e zgjatur, ka përsëritje të shumta situatash, figurash stilistike e mendimesh. Mungon përshkrimi i mjedisëve; natyra përshkruhet pa veçanti; personazhet karakterizohen kryesisht me anë të fjalëve dhe veçorive të jashtme; etj. Me gjithë këto, "*Historia e Skënderbeut*", mbeti një nga veprat më me rëndësi të Rilindjes dhe i ruan përherë vlerat poetike dhe edukative patriotike.<sup>44</sup>

Poema "*Qerbelaja*" është një poemë epike fetare që përbëhet prej njëzet e pesë këngësh, që flet për betejën e Qerbelasë në Irak në vitin 680 të erës sonë, ku u vra Hysenit, nip i profetit Muhamed.<sup>45</sup>

<sup>41</sup>Grup autorësh, "Historia e letërsisë shqipe I-II", Botim i tretë, Prishtinë, 1975, fq.492.

<sup>42</sup>Vepra e cituar, fq.493.

<sup>43</sup>Sabri Hamiti, "*Historia e letërsisë shqiptare*", Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.221.

<sup>44</sup>Sabri Hamiti, "*Historia e letërsisë shqiptare*", Rilindja, Prishtinë, 1989, fq.222.

<sup>45</sup>Robert Elise, "*Historia e letërsisë shqiptare*", Botimi i dytë, Dukagjini, Pejë, 2001, fq.178.

Temën e saj Naim Frashëri e merr prej historisë fetare arabe dhe, në një trajtë shumë më të rrudhur, e trajton më parë në vjershën lirike Abaz-Aliu të përmbledhjes “*Luletë e Verësë*”.<sup>46</sup>Në Qerbelanë trajtohet historia fetare arabe prej shekullit IX deri në shekullin XVII dhe trajtohet e shkoqitur si luftë ndërmjet imam Aliut me Mavijën, imam Hysenit me Jezitin dhe Myftarit me Mervanin.

Me ndryshim prej “Historisë së Skënderbeut”, që është një histori në vargje më parë e luftërave se sa e gjithë jetës së Skënderbeut, që është, pra, një vepër në të cilën ka një personazh boshtor, rreth të cilit zhvillohet i gjithë tregimi, *Qerbelaja* është një histori në vargje e luftërave ndërmjet familjeve kundërshtarë, rreth khalifatit arab që bëhen në fushë të *Qerbelasë*. Për këtë arsye ajo nuk ka një personazh boshtor, siç e ka Historia e Skënderbeut. Po ashtu është fusha e *Qerbelasë* në këtë poemë, pika e rëndësës së ngjarjeve dhe të luftërave që paraqiten në të. Në *Qerbelanë* mbulohen disa shekuj. Kalimi ashtu i shpejtë i kohës, tregimi, ashtu i përmbledhur, i shkurtuar për ngjarjet në vend të tregimit të ngjarjeve është këtu, në Qerbelanë, shumë më i theksuar se sa në Historinë e Skënderbeut. Se si duket tregimi i këtillë i përmbledhur, në të vërtetë, kalimi i këtillë i shpejtë i kohës në Qerbelanë më së miri mund të shihet prej këtij shembulli, në të cilin paraqitet ndërimi i sundimtarëve të khalifatit:

*Pas ati ndenjtë Jeziti,  
q' e kishte vëlla Veliti  
pas ati ndenjtë Hyshani,  
që hoqi soje Imami.  
Pas Hyshanit ndenj Veliti,  
q' e kishte djalë Jeziti.*<sup>47</sup>

Mundimet e shumta në kushtet e vapës afrikane; urrejtja fanatike, që cilëson sektit brenda një feje, ashpërsia që nxit lufta për pushtet, të gjitha këto sikur janë rrethana plotësuese tematike me të cilat ashpërsohet edhe më tepër shestin dualist emocional i kësaj poeme. *Qerbelaja* nuk mund të kënaqë kërkesat estetike të lexuesit shqiptar në masën në të cilën mund t'i kënaqë Historia e Skënderbeut. Përmbajtja fetare gjithsesi është një përbërës kufizues i ndikimit të saj artistik. Kufizimi i saj i këtillë, ndërkaq, kurrsesi s' do të duhej të ishte arsye që të mos studiohet, si edhe veprat e tij të tjera dhe të mos çmohet si një poemë e rëndësishme me të cilën pasurohet krijimtaria jonë poetike romantike, përgjithësisht, kurse krijimtaria poetike e Naim Frashërit, veçanërisht.<sup>48</sup>

<sup>46</sup> Rexhep Qosja, “*Historia e letërsisë shqipe*”, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.261.

<sup>47</sup> Vepra e cituar, fq.263.

<sup>48</sup> Vepra e cituar, fq.264.

## Rëndësia e shkrimeve të Naimit në gjuhë të huaja

Megjithëse një kohë të gjatë, përafërsisht deri në vitet shtatëdhjetë të shekullit tonë, të panjohura dhe të pahulumtuara prej studiuesve të krijimtarisë së tij, shkrimet e Naim Frashërit në gjuhë të huaja kanë rëndësi historiko-kulturore, apo edhe artistike.<sup>49</sup>

Prej shkrimeve të N.Frashërit në gjuhë të huaja si: në persishte, në turqishte dhe në greqishte rëndësi artistike kanë përmbledhja e vjershave “*Ëndërrime*” (*tahayyulat*), proza poetike “*Katër stinët*”, poema atdhetare “*Dëshira e vërtet’ e Shqiptarëve*” ( *O alithis pathos ton Skypetaros*) dhe poema lirike “*Dashuria*” ( *O eros*).Rëndësi historiko-kulturore dhe dëshmuese ndërkaq, kanë të gjitha shkrimet e tij në gjuhë të huaja. Gjithanshmëria e kërshërisë dhe shumëgjuhësia e krijimtarisë poetike dhe, në përgjithësi, letrare e diturore të Naim Frashërit i detyrohet vërtet, shkollimit në gjimnazin e Zosimeajve të Janinës, por shumëgjuhësia e krijimtarisë së tij poetike dhe diturore, kushtëzohet, pak a shumë, edhe prej rrethanave historike, shoqërore dhe politike, në të cilat ai ishte rritur dhe do të jetojë.<sup>50</sup>

Shkrimet, përkthimet a përshtatjet e Naim Frashërit në gjuhën persishte dhe turqishte, që i boton duke filluar prej vitit 1871 deri në vitin 1884, përkatësisht 1886, përbëjnë fazën e parë të krijimtarisë së tij.<sup>51</sup>

Vepra e parë që shkruan në gjuhë të huaj dhe, njëkohësisht, vepra e parë që Naim Frashëri boton është “*Gramatika e persishtes sipas metodës së re*” e botuar në vitin 1871 dhe, pastaj, e ribotuar më 1887. Botimi i kësaj vepre dëshmon se Naim Frashëri është njëri prej poetëve të romantizmit shqiptar, që para se të merret me poezinë ka filluar të merret me gjuhësinë, por botimi i kësaj vepre dëshmon, gjithashtu, se Naimi është romantiku ynë, që para se të merret me çështje të gjuhës shqipe, ka filluar të merret me çështje të një gjuhe tjetër: në këtë mes të gjuhës persishte. Duke e shkruar “*Gramatikën e persishtes sipas metodës së re*” ai sikur ka për qëllim t’i dalë borxhit një gjuhe dhe një kulture ndaj të cilave ndien një afri të veçantë, me të cilën ishte pajisur qoftë edhe në fëmijëri, gjatë mësimëve që kishte marrë prej hoxhës së fshatit.<sup>52</sup>

Përpos “*Gramatikës së persishtes sipas metodës së re*”, në fillimet e veprimtarisë së tij letrare dhe kulturore, Naimi do të shkruajë e do të botojë në turqishte edhe një vepër tjetër diturore popullarizuese: veprën “*Shpikje dhe zbulime*”. Këtë vepër ai e botoi më 1881, domethënë 10 vite pas Gramatikës së persishtes sipas metodës së re dhe një vit para se të vendosej përgjithmonë në Stamboll. Sikundër edhe mund të kuptohet prej titullit të saj, këtë vepër të vogël autori e shkruan dhe e boton me qëllim të popullarizimit të shpikjeve e të zbulimeve, me të cilat, i merr mendja, është ndriçuar mendja e njeriut dhe janë përmirësuar

<sup>49</sup> Rexhep Qosja, “*Historia e letërsisë shqipe*”, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.73.

<sup>50</sup> Vepra e cituar, fq.74.

<sup>51</sup> Vepra e cituar, fq.75.

<sup>52</sup> Vepra e cituar, fq.68.

kushtet e jetës së tij. Kështu fjala vjen, në tëai flet për fenerin, qelqin, pasqyrën, dylbinë, armët e ndryshme, letrën, barometrin, termometrin, telegrafin, fotografinë, e për mjete të tjera, që në atë kohë kishin filluar gjerësisht të përdoshin në jetën e përditshme të Evropës e të Amerikës, por ende nuk kishin depërtuar më gjerësisht në Turqi dhe në vende të tjera të Perandorisë Otomane. Në këtë vepër ai, njëkohësisht, e thekson rolin e madh, vendimtar, për zhvillimin e qytetërimit të shkencës moderne dhe të filozofisë pozitiviste, që janë të lidhura, madje, të kushtëzuara ndërmjet vete. Si Gramatika e persishtes sipas metodë së re, as Shpikjet dhe zbulimet nuk mund të quhet vepër shkencërisht e rëndësishme në krijimtarinë e Naim Frashërit dhe, nuk mund të quhet vepër, ashtu e rëndësishme, në radhë të parë, për shkak se, si vepër shkencore popullarizuese, është e vjetruar me idetë dhe me metodën e paraqitjes së tyre. Sikundër Gramatika e persishtes sipas metodës së re, ashtu edhe Shpikjet dhe zbulimet është e rëndësishme, ndërkaq, për të njohur, në njërën anë, botëkuptimin shkencor e, në anën tjetër, burimet prej të cilave ushqej ai me ide e njohuri të reja.<sup>53</sup>

Fazës së parë të krijimtarisë së Naimit , e quajtur fazë e krijimtarisë në gjuhë të huaj, i takon edhe proza, vonë e gjetur dhe e shqipëruar: “Katër stinët”. Sikundër edhe i shkruan në faqen e parë, pas ballinës, proza Katër stinët është marrë nga frëngjishtja dhe është botuar, në vitin 1884, në Biblotekën e Xhepit, që kishte themeluar i vëllai i Naimit, Sami Frashëri. Megjithëse e përshtatur në prozë, Katër stinët është një prozë poetike në të cilën lirizmi pers përcakton qëndrimin e subjektit poetik ndaj jetës dhe ndaj botës, në përgjithësi. Me kuptimin e saj simbolik mbi ndërrimet e stinëve të vitit, proza poetike Katër stinët sikur e kënaqë botëkuptimin e autorit mbi ndryshimet e vazhdueshme në natyrë e në jetë, por, me kuptimin e saj simbolik ajo sikur e kënaqë edhe dëshirën e tij prej prijësi shpirtëror në Rilindjen Kombëtare Shqiptare mbi ndryshimet e domosdoshme në historinë dhe në jetën shoqërore të popujve. Përpos prozës poetike, Katër stinët, në turqishte Naimi do të përkthejë e të botojë, më 1886, edhe Këngën e Parë të Iliadës, të cilën, madje, do ta përkthejë e ta botojë edhe në gjuhën shqipe më 1896. Përkthimi që N. Frashëri i bën Këngës së Parë të *Iliadës* në gjuhën turke është, në përgjithësi, përkthim i parë i ndonjëres prej këngëve të epopeve të mëdha të Homerit në turqishte. Përkthimin e kësaj kënge në turqishte ai e bën prej greqishtes së vjetër, prej së cilës e përkthen edhe në shqip.<sup>54</sup>

Përpos në turqishte Naim Frashëri do të shkruajë e të botojë edhe në persisht. Në këtë gjuhë ai do të shkruajë përmbledhjen e vjershave “*Ëndërrime*” (tahayyulat), të cilën e boton në vitin 1884. Vjershat e kësaj përmbledhje autori filloi t’i shkruajë më herët, disa prej tyre, madje, në kohën kur e boton Gramatikën e persishtes sipas metodës së re. Në qoftë se vitet që shënon në fund të disa prej vjershave të kësaj përmbledhje merren si data të sakta të shkrimit të tyre, atëherë

---

<sup>53</sup>Vepra e cituar, fq.70.

<sup>54</sup>Vepra e cituar, fq.71.

do të dilte se përmbledhjen *Ëndërrime* ai fillon ta shkruajë në vitin 1872-1873 domethënë në moshën 26-27 vjeçare, kur ende nuk kishte filluar të shkruante në gjuhën shqipe.

Megjithëse e shkruar në një gjuhë të huaj që, kryesisht, njihej prej lexuesve shqiptarë dhe megjithëse e panjohur një kohë të gjatë prej lexuesve dhe studiuesve të veprës së tij, përmbledhja *Ëndërrimet* është një vepër e rëndësishme, madje, vepra më e rëndësishme që Naim Frashëri ka shkruar në gjuhë të huaja. Për më tepër, ajo mund të çmohet si një prej veprave më të rëndësishme për njohjen e kërkimit letrar, të procedimit krijues dhe, më në fund, të botëkuptimit të N.Frashërit, në përgjithësi. Përmbledhja *Ëndërrime* përfaqëson hyrjen mjaft të pjekur, si në pikëpamje të mendimeve, ashtu edhe në pikëpamje të mjeshtërisë krijuese, në poezinë e tij të shkruar shqip, posaçërisht në poezinë e tij filozofike. Më vonë se në turqishte e në persishte, ndërkaq, N.Frashëri do të shkruajë edhe në një gjuhë të huaj: në gjuhën greqishte.<sup>55</sup>

Në greqishte Naim Frashëri do të shkruajë dy vepra, por dy vepra dukshëm më të çmuara se sa veprat e shkruara në turqishte dhe të çmuara gati sa edhe përmbledhja e vjershave e shkruar në persisht, *Ëndërrime*: do të shkruajë poemën atdhetare "*Dëshira e vërtet e Shqipëtarëve*" (*o alithis pathos ton Skypetaron*) dhe poemën lirike "*Dashuria*" (*O eros*). Poemën e parë, Naimi për herë të parë e boton në Bukuresht në vitin 1886, kurse poemën e dytë *Dashuria*, për herë të parë e boton në Stamboll, në vitin 1895. Megjithëse e shkruar në gjuhën greke, poema *Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve* është një vepër, që i takon fazës së dytë të krijimtarisë së Naim Frashërit, kur ai shkruan në gjuhën shqipe dhe kur, në veprat e shkruara në gjuhën shqipe, do të shprehë të gjitha veçoritë ideo-tematike dhe stilistike, që do të cilësojnë gjithë krijimtarinë e tij. Përmes kësaj poeme ai, në të vërtetë, dëshiron t'ua bëjë me dije grekëve dëshirat e vërteta të shqiptarëve, idetë dhe idealet e tyre, përpjekjet për pavarësinë kombëtare dhe dëshirën për fqinjësi të mirë, po të barabartë, me ta dhe me të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit. Poema në fjalë, pa dyshim, përfaqëson një si program historik dhe politik të shkruar e të botuar greqisht, në vargje, në të cilën përmbledhet Rilindja Kombëtare Shqiptare. E nxitur prej arsyesh të tjera krijuese, ndërkaq është e shkruar poema e dytë e N.Frashërit, *Dashuria*.

Në qoftë se poemën *Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve* autori e shkruan në gjuhën greke me qëllim që opinionin grek ta njoftojë me luftën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, poemën tjetër, *Dashuria* do ta shkruajë e do ta botojë në greqishte qoftë edhe për të treguar sa rëndësi kishte kultura greke në jetën e tij, dhe në qoftë se poema e parë e dëshmon interesimin e tij për të ndikuar në opinionin politik grek, poema e dytë e dëshmon lidhjen e tij me kulturën greke, në të vërtetë dashurinë që ai, më në fund, si edhe romantikët tanë të tjerë, ndien për traditat e lashta letrare, filozofike dhe etike greke.<sup>56</sup>

---

<sup>55</sup>Vepra e cituar, fq.72.

<sup>56</sup>Vepra e cituar, fq.73.

## Autorët që u morën me jetën dhe veprën e Naim Frashërit

Biografët e kritikët e tij të derisotëm janë marrë kaq me jetën e me idetë e tij, më tepër duke përgjithësuar sesa duke analizuar, Konica i pari ka theksuar se Naimin do ta ndjekë një komb i tërë. Nipi i tij Midhat Frashëri e rindërtoi intimën njerëzore e krijuese të poetit, e cila u rimor më sistematikisht nga Krist Maloki, që zgjimin personal të Naimit e shihte si zgjim të kombit në vështrimin psikoanalistik. Çabej, i vitit 1936, vërejti se studiuesit e kanë të vështirë ta ndajnë apostullin nga poeti, kurse Çabej, i vitit 1945, këtë ide e zhvillon tutje për të përfunduar: “Naimi ishte para së gjithash edukator. Poeti qëndron pas patriotit. Idealet artistike ia sakrifikoi kryesisht përpjekjes nacionale-politike. Do të pranojmë se me përjashtim të disa pak vjershave vlera letrare e poezive të tij është e paktë. Sepse veprat e tij më fort se qëllimit estetik i shërbenin një qëllimi etik. Këtij qëllimi, që të bashkojë kombin e tij, ta lartësojë këtë në pikpamje morale e kulturore, poeti ia mbërriti. Kështu Naimi i përket si kulturës ashtu edhe lëvizjes nacionale të shekullit XIX”.

Nga ana tjetër Qosja, Shutriqi e Resuli, secili në mënyrën e vet, duke përshkruar veprat e tij, duke shqyrtuar idetë themelore apo sistemin botëkuptimor, sipërtheksojnë nacionalizmin dhe moralizmin naimjan për të arritur te formula gjithpërfshirëse *porosia e madhe*, që shfaqet si titull i monografisë së Rexhep Qosjes.<sup>57</sup>

Ali Aliu tek vepra e tij Magjia e fjalës për Naimin citon se majat poetike te gjeniut tonë janë prekur vetëm përmes vargjeve të shpirtit. Nuk ka dyshim se, edhe si poet, edhe si mësues, si veprimtar dhe patriot, Naim Frashëri ndikoi në zgjimin kombëtar.<sup>58</sup>

Mendimi im rreth veprimtarisë së Naim Frashërit: është vjershëtori i dashurisë me një gjuhë të thellë përjetuese. Në anën tjetër ai me një krenari të veçantë i këndon atdheut duke e vënë Shqipërinë e vet përmbi te gjithë popujt tjerë duke inspiruar kështu lexuesit për atdhedashuri të çilter siç e kishte edhe ai. Me krijimtarinë e tij letrare dha kontribute të pazëvendësueshme për lëvizjen mbarë kombëtare.

---

<sup>57</sup> Sabri Hamiti, “*Letërsia filobiblike Letërsia romantike*”, F. Konica, Prishtinë, 2002, fq.342.

<sup>58</sup> Ali Aliu, “*Magjia e fjalës*”, Dukagjini, Pejë, 2003, fq.10.



## **Të gjitha veprat e njohura të Naimi Frashërit:**

Naim Frashëri është autori i gjithsej njëzet e dy veprave: katër në turqishte, një në persishte, dy në greqishte dhe pesëmbëdhjetë në shqipe.<sup>59</sup>

### **Veprat në shqip**

1. *Bagëti e bujqësia*, Bukuresht, 1886
2. *E këndimit çunavet*, Këndonjëtorja, Bukuresht, 1886
3. *Istoria e përgjithëshme për mësonjëtoret të para*, Bukuresht, 1886
4. *Vjersha për mësonjëtoret e para*, Bukuresht, 1886
5. *Dituritë për mësonjëtoret para*, Bukuresht, 1888
6. *Luletë e verësë*, Bukuresht, 1890
7. *Mësime*, Bukuresht, 1894
8. *Parajsa dhe fjala fluturake*, Bukuresht, 1894
9. *Gjithësia*, Bukuresht, 1885
10. *Fletore e Bektashinjët*, Bukuresht, 1896
11. *Iliadh' e Omirit*, Bukuresht, 1896
12. *Istoria e Skënderbeut*, Bukuresht, 1898
13. *Qerbelaja*, Bukuresht, 1898
14. *Istoria e Shqipërisë*, Sofje, 1899
15. *Shqipëria*, Sofje, 1902.

### **Vepra në turqisht**

1. *Gramatika e persishtes sipas metodës së re*, Stamboll, 1871
2. *Shpikje dhe zbulime*, Stamboll, 1881
3. *Katër stinët*, Stamboll, 1884
4. *Iliada*. Vepër e Homerit përkthyer prej origjinalit greqisht, Stamboll, 1886.

### **Vepra në persisht**

1. *Ëndërrime*, Stamboll, 1884

### **Vepra në greqisht**

1. *Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*, Bukuresht, 1886
2. *Dashuria*. Poemë origjinale në tetë këngë të ilustruara, Stamboll, 1895.<sup>60</sup>

---

<sup>59</sup>Robert Elise, “*Historia e letërsisë shqiptare*”, Dukagjini, Pejë, 2001, fq.175.

<sup>60</sup>Sabri Hamiti, “*Letërsia filobiblike Letërsia romantike*”, F.Konica, Prishtinë, 2002, fq.368.

## Përfundim

Naim Frashëri, konsiderohet si poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare dhe veprimtar i shquar i arsimit dhe kulturës kombëtare në përgjithësi. Ai me veprën e tij pasqyroi, përpunoi, përqafoi dhe përhapi idealet për lëvizjen kombëtare. Veprimtaria e tij letrare është trajtuar dhe studiuar nga shumë autorë, dhe përgjithësisht është vlerësuar shumë lartë në kontekst kohor.

Nëtemën *“Veprimtaria letrare e Naim Frashërit”* kemi parashtruar veprimtarinë letrare të ideologut tone të madh, dhe figurës kryesore të Rilindjes Kombëtare, Naim Frashërit. Synimi ishte që përmes kërkimeve dhe shqyrtimeve tona të paraqesim krijimtarinë dhe rëndësinë e saj, historikun dhe zhvillimin e letërsisë shqipe si dhe përkushtimin e tij patriotik.

Trajtimi i kësaj teme paraqet njërendësi të madhe, ngase vihen në dukje vlerat e çmueshme për historinë e letërsisë shqipe, në radhë të parë, si dhe vlerat e një krijuesi me prirje të gjithanshme, me mundësi që të shkruajë në disa gjuhë.

Gjatë trajtimit të veprave të tij vërejmë se ai, kryesisht ishte poet lirik, po shkroi edhe vjersha didaskalike. Është me rëndësi të theksohet se bëri edhe përkthime dhe përshtatje, sidomos fabulën. Shkroi historinë e vjershëruar, gjë që ishte një hap drejt poemës epike-historike.

Ai, gjithashtu provoi, me sukses edhe tregimin e shkurtër, sidomos për fëmijë. Prandaj edhe konsiderohet se është një nga themeluesit kryesor të letërsisë sonë për fëmijë.

Poeti bëri një punë të mirë për pasurimin e metrikës shqipe me vargje e strofa të reja. Puna e tij qe e çmueshme për njëjtësimin, sidomos të toskërishtes letrare, për ngritjen e mundësive shprehëse të shqipes si gjuhë arti dhe kulture. Gjuha e poetit ishte kryesisht artistike dhe e gjallë, përmban figura të spikatura letrare. Ai i këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut, të cilën e shpreh aq bukur në poemën *“Bagëti e bujqësia”*, nga ana tjetër, me krijime të ndryshme bëri thirrje dhe dha mesazhe të fuqishme për çlirimin e atdheut, për begatimin e tij me një të ardhme demokratike të tij *“Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”*

Nëpërmjet veprave të tij vërejmë se Naimi mburret për të kaluarën e lavdishme të atdheut, ka besim në forcat e popullit dhe shpresa të ndritura për të ardhmen. Hymnizon natyrën e maleve, të fushave shqiptare dhe digjet nga malli për vendlindjen. Ai, godet armiqtë dhe stigmatizon tradhtinë. I këndon të kaluarës së lavdishme, periudhës së Skënderbeut, trimërisë e bashkimit, dhe çdo gjë shqiptare i ngjanë e bukur dhe e madhërishme.

Naim Frashëri, si poet u bë i pavdekshëm në mesin e shqiptarëve, prandaj që në shfaqje veprat e tij zgjuan edhe interesimin e studiuesve dhe kritikëve të tij. Studimet rreth veprës së tij letrare kurrë nuk kanë mundur ta përcjellin opinionin mitizues dhe himnizues që është krijuar rreth veprës së tij dhe emrit të tij.

Figura Naim Frashërit, paraqet një shembull parësor i intelektualit në kohën e Perandorisë Osmane të shekullit XIX. Njihte kulturën e Lindjes dhe të Perëndimit. Orientimi i tij dhe fokusimi në tremat krijuese, është në kahun perëndimor. Aty ku e kishin vendin të parët e tij.

Prandaj, si përfundim mund të thuhet se ndikimi, qysh në gjallje të shkrimtarit, por edhe pas vdekjes, jo vetëm të shkrimtarët shqiptarë të kohës, por edhe të periudhës së mëvonshme, ishte i madh. Kështu u vunë në pah dhe u çmuan gjerësisht meritat dhe vlerat e punës në krijimtarinë e tij, që shpërfaqen përmes qasjeve, trajtimeve e studimeve të ndryshme. Vlerat e veprës së tij e dëshmojnë edhe ribotimet e shumta. Përveç kësaj janë shkruar e bërë edhe disa botime kritike shkencore të veprave të Naimit, nga autorë të ndryshëm.

## Literatura

1. Aliu, Ali , **“Magjia e fjalës”**, Dukagjini,Pejë, 2003.
2. Bulka, Nonda, **“Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë”**, Elbasan, 2001.
3. Gurakuqi, Karl. **“Shkrimtarët shqiptarë”** (Rilindja 2), Pakti, Tiranë, 2007. (Botimi i parë 1941)
4. Hamiti, Sabri, **“Historia e letërsisë shqiptare “**, Rilindja, Prishtinë, 1989.
5. Qosja, Rexhep, **“Historia e letërsisë shqipe” (Romantizmi III)**, Rilindja, Prishtinë, 1990.
6. Grup autorësh, **“Historia e letërsisë shqipe I-II”**, Botim i tretë, Prishtinë, 1975.
7. Hamiti, Sabri, **“Letërsia filobiblike Letërsia romantike” Veprimtaria letrare 7**, Faik Konica, Prishtinë,2002.
8. Elise, Robert, **“Histori e letërsisë shqiptare”**, Botimi i dytë, Dukagjini, Pejë, 2001.
9. Xholi, Zija, **“Mendimtarët e Rilindjes Kombëtare”**,8 Nëntori, Tiranë, 1987.